



**Themelohen Kolegjet
Mbikëqyrëse për agjencitë
ndërkombëtare të vlerësimit e
klasifikimit të riskut të kredisë
(Credit Rating Agencies)**

Vijon në faqen 2

VËSHTRIM MBI TREGJET

**Zhvillimet e tregut të sigurimeve në
Shqipëri, janar-tetor 2013**

Vijon në faqen 2

**Zhvillimet e tregut të pensioneve private
vullnetare, 30 tetor 2013**

Vijon në faqen 4

**Zhvillimet e Tregut të Fondeve të
Investimeve, 30 tetor 2013**

Vijon në faqen 4

ZHVILLIME TË TJERA

**Zhvillohet Forumi Global mbi Pensionet
Private dhe Mbledhja e Përgjithshme
Vjetore e IOPS-it
(4-6 nëntor 2013)**

Vijon në faqen 4

**Seminar rajonal “Vlerësimi i modeleve të
brendshme: qasje sasiore dhe cilësore”
(19-21 nëntor 2013)**

Vijon në faqen 6

**Seminar ndërkombëtar “Vendosja e
konsumatorit në qendër të rregullimit dhe
mbikëqyrjes”
(27-30 nëntor 2013)**

Vijon në faqen 7

LAJMET NGA RAJONI

Greqi

Vijon në faqen 7

Kosovë

Vijon në faqen 8

Kroaci

Vijon në faqen 8

Rumani

Vijon në faqen 9

Rusi

Vijon në faqen 10

Kolegjet do të krijojnë mekanizma për shkëmbim dhe diskutim informacioni rreth funksionimit të modeleve të vlerësimit dhe metodologjive, procedurave të kontrollit të brendshëm për të menaxhuar konfliktet e interesit, etj.

Themelohen Kolegjet Mbikëqyrëse për agjencitë ndërkombëtare të vlerësimit e klasifikimit të riskut të kredisë (Credit Rating Agencies)

Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Letrave me Vlerë (IOSCO) njoftoi se janë ngritur Kolegjet Mbikëqyrëse për agjencitë e vlerësimit e klasifikimit të riskut të kredisë (*Credit Rating Agencies*) si Standard & Poor's, Moody's dhe Fitch. Takimet inauguruese u bënë në 5-6 nëntor në New York. Kolegjet për S&P dhe Moody's kryesohen nga Komisioni i Letrave me Vlerë i SHBA (SEC) dhe kolegji për Fitch kryesohet nga Autoriteti Evropian i Letrave me Vlerë dhe Tregjeve (ESMA).

Krijimi i këtyre kolegjeve ndjek rekomandimet që IOSCO ka bërë në raportin e saj përfundimtar mbi Kolegjet Mbikëqyrëse për agjencitë e vlerësimit e klasifikimit të riskut të kredisë të botuar në korrik 2013. Kolegjet për këto agjenci do të krijojnë një mekanizëm për shkëmbim dhe diskutim informacioni lidhur me:

- Përputhshmërinë e agjencive të vlerësimit e klasifikimit me legjislacionin dhe rregulloret lokale e rajonale;
- Zbatueshmërinë dhe aderimin nga agjencitë e vlerësimit e klasifikimit tek Kodi i Sjelljes për këto agjenci i hartuar nga IOSCO;
- Ngritjen e funksionimit e modeleve të vlerësimit dhe metodologjive, procedurat e kontrollit të brendshëm për të menaxhuar konfliktet e interesit, procedurat për trajtimin materialeve dhe informacionit jo-publik, me synim promovimin e të kuptuarit më të mirë të rreziqeve me të cilat përballet një agjenci vlerësimi e klasifikimi sot si edhe rolin e mbikëqyrësve.

AMF është anëtare me të drejta të plota në Organizatën Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Letrave me Vlerë, IOSCO dhe njëkohësisht nënshkruese e Memorandumit Shumëpalësh të IOSCO-s që prej vitit 2009. Ky memorandum i ka shërbyer në vazhdimësi AMF-së për të shkëmbyer informacione të vlefshme me rregullatorë të tjerë të fushës së letrave me vlerë, duke qënë kështu një instrument të vlefshëm në mbikëqyrjen e këtij tregu.

VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-tetor 2013

Tregu i sigurimeve u ul me 10.51% gjatë periudhës janar-tetor 2013. Vlera e primeve të shkruara bruto në këtë periudhë arriti rreth 6.61 miliardë lekë. Kjo u shoqërua edhe me ulje të numrit të policave të sigurimit me rreth 4.16% duke arritur në 831,282 polica.

Një tjetër tregues i ecurisë së tregut, dëmet e paguara bruto, në total, regjistruan një rritje me 1.88% në krahasim me janar-tetor 2012. Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara bruto i përket sigurimit motorik me rreth 1.92 miliardë lekë, apo 82.55% të totalit të dëmeve të paguara bruto.

Sigurimi i Jo-Jetës

Sigurimi i Jo-Jetës u ul me 12.85% gjatë periudhës janar-tetor 2013, krahasuar kjo me të njëjtën periudhë e një viti më parë.

Sigurimi i detyrueshëm motorik

Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik vlerësohen të kenë arritur vlerën rreth 3.03 miliardë lekë gjatë periudhës janar-tetor 2013, duke shënuar një ulje prej 17.81% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Sigurimi i detyrueshëm motorik gjatë periudhës raportuese përbën 46% të sigurimeve të Jo-Jetës.

Klasa të tjera në sigurimet e Jo-Jetës

Ndër klasat e tjera kryesore të sigurimit të Jo-Jetës veçohen:


- *zjarri, forcat e natyrës dhe dëmtime të tjera në pronë të cilat zunë 22.81% të tregut të Jo-Jetës;*
- *sigurimi i aksidenteve, sigurimi i shëndetit dhe sigurimi i përgjegjësi të përgjithshme të cilat së bashku zunë 13.89% të tregut të Jo-Jetës.*

Sigurimi i Jetës

Sigurimi i Jetës u rrit me 9.57% krahasuar me janar-tetor të vitit 2012. Pjesa më e madhe e primeve të shkruara bruto i përket sigurimit “Jetë debitori” dhe përbën 64.26% të sigurimit të Jetës.

Ndarja e tregut të sigurimeve, janar-tetor 2013

Grafiku më poshtë paraqet ndarjen e volumit total të primeve të shkruara bruto sipas grupeve kryesore.



Gjatë periudhës janar-tetor 2013, dëmet e paguara bruto, në total, regjistruan një rritje me 1.88% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Sipas analizës së të dhënave për tregun e Fondeve të Investimeve në 30.09.2013, vlera neto e aseteve të Fondeve, arriti rreth 40.85 miliardë lekë me një rritje prej 155.16% krahasuar me 31.12.2012

Zhvillimet e tregut të pensioneve private vullnetare, 30 tetor 2013

Gjatë nëntëmujorit të vitit 2013 në tregun e pensioneve private vullnetare ushtruan aktivitetin e tyre tre fonde pensioni. Analiza e të dhënave për tregun e pensioneve private vullnetare në 30.09.2013 tregon një total asetesh nën menaxhim prej 400.95 milionë lekë dhe me një rritje prej afro 117.35 milionë lekë (41.38%).

E shprehur në euro, totali i aseteve nën menaxhim është 2.84 milionë euro. (Sipas kursit zyrtar të këmbimit ("fiksi") 30.09.2013 në Bankën e Shqipërisë, 1 euro = 141.37 lekë, <http://www.bankofalbania.org/>)

Numri i anëtarëve në fondet e pensioneve në 30.09.2013 ishte 7,852 anëtarë, duke shënuar rritje prej 7.84% krahasuar me fundin e vitit 2012.

Zhvillimet e Tregut të Fondeve të Investimeve, 30 tetor 2013

Në tregun e Fondeve të Investimeve, gjatë nëntëmujorit të vitit 2013, ushtruan aktivitetin e tyre dy fonde investimi, përkatësisht "Fondi i Investimeve Raiffeisen Prestigj" dhe "Fondi Raiffeisen Invest Euro".

Sipas analizës së të dhënave për tregun e Fondeve të Investimeve në 30.09.2013, vlera neto e aseteve të Fondeve, arriti rreth 40.85 miliardë lekë me një rritje prej 155.16% krahasuar me 31.12.2012.

Ky treg dominohet kryesisht nga investimet në Obligacione Qeveritare të cilët përbëjnë 74.23% të aseteve të fondeve, me rritje prej 164.77% krahasuar me 31.12.2012.

Numri i anëtarëve që kanë investuar në Fondet e Investimit më 30.09.2013 është 32,080.

ZHVILLIME TË TJERA

Zhvillohet Forumi Global mbi Pensionet Private dhe Mbledhja e Përgjithshme Vjetore e IOPS-it

(4-6 nëntor)

Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Pensioneve, (IOPS) në bashkëpunim me Organizatën për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD) zhvilluan në datat 5-6 nëntor, në Seul, Koreja e Jugut, Forumin Global mbi pensionet private. Pjesëmarrës në Forum ishin zyrtarë nga autoritetet rregullatore dhe mbikëqyrëse, ekspertë të nivelit të lartë nga industria e fondeve private të pensionit dhe institutet kërkimore nga vendet anëtare të të dyja organizatave OECD dhe IOPS, si dhe pjesëmarrës nga

rajoni i Azisë së Paqësorit. Përfaqësues ishin edhe anëtarë nga organizatat ndërkombëtare, përfshirë Bankën Botërore dhe Bankën Aziatike të Zhvillimit. Në këtë aktivitet merrnin pjesë edhe përfaqësues të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare të Shqipërisë, si vend anëtar i IOPS-it.

Diskutimet në Forumin Global u fokusuan në një numër çështjesh rregullatore dhe mbikëqyrëse që ndikojnë në skemat e pensioneve private dhe publike në rajonin e Azisë. Qëllimi ishte identifikimi i praktikave më të mira dhe marrja e përvojave nga vendet anëtare të OECD dhe IOPS.

Tematikat kryesore të trajtuara në sesione ishin:

- Rishikimi i reformave kryesore në sistemet e pensioneve të Azisë, duke u fokusuar në mundësitë dhe sfidat për zhvillimin dhe kombinimin e programeve të sigurimeve shoqërore dhe planet të pensioneve private në rajonin e Azisë;
- Shqyrtimi i rolit që anuitetet mund dhe duhet të luajnë në mbrojtjen e individëve me perspektivën e jetëgjatësisë të zgjatur; pa harruar se vetë ofruesit e këtyre produkteve, anuiteteve, luajë një rol thelbësor;
- Çështjet dhe sfidat e hasura nga mbikëqyrësit në shpërndarjen dhe këshillimin mbi anuitetet. Vëmendje do t'i kushtohet edhe çështjeve lidhur me përpjekjet për të rritur të kuptuarin që individët kanë ndaj këtyre produkteve; për të lehtësuar zgjedhjen e tyre në produktin e pensionimit që i përshtatet më mirë interesat dhe nevojave të tyre, si dhe rritjen e mbrojtjes së konsumatorit.
- Struktura e brendshme e qeverisjes dhe organizimi i autoriteteve mbikëqyrëse të pensioneve.

Në Forum u prezantuan edhe gjetjet kryesore të projektit G-20/OECD për investitorët institucionalë dhe investimet afatgjata. Këto përfshijnë edhe parimet mbi financimin e investimeve afatgjatë nga investitorët institucionalë miratuar nga liderët e G20 në takimin e tyre në shtator 2013.

Krahas Forumit, u zhvillua edhe takimi i Komitetit Teknik dhe Mbledhja e Përgjithshme Vjetore e IOPS-it në datat 4-5 nëntor. Në këto takime u prezantuan dhe diskutuan reformat e ndërmarra në fushën e pensioneve private nga disa prej vendeve anëtare, u diskutua dhe u miratua dokumenti "Praktikat e mira të IOPS-it për qeverisjen e autoriteteve mbikëqyrëse të pensioneve", u diskutuan një sërë materialeve studimore për fushën e pensioneve që kanë për qëllim të mbështesin autoritetet mbikëqyrëse anëtare të IOPS-it me literaturë. Gjithashtu u votua për emërimin e presidentit të ri të IOPS-it dhe të anëtareve të Komitetit Ekzekutiv, si dhe u miratua programi i punës dhe buxheti.

Forumi diskutoi çështjet dhe sfidat e hasura nga mbikëqyrësit në shpërndarjen dhe këshillimin mbi produkteve anuitete, në përpjekjet për të rritur të kuptuarin që individët kanë ndaj këtyre produkteve

Seminar rajonal “Vlerësimi i modeleve të brendshme: qasje sasore dhe cilësore”

(19-21 Nëntor 2013)

“Vlerësimi i modeleve të brendshme: qasje sasore dhe cilësore” ishte tema e seminarit të organizuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të Polonisë, në Varshavë, në datat 19-21 nëntor 2013. Në këtë seminar merrnin pjesë aktuarë si dhe drejtues të Autoritete Mbikëqyrëse të Sigurimeve të



12 shteteve të ndryshme si: Armenia, Azerbajxhan, Bosnje Hercegovina, Finlanda, Gjermania, Hungaria, Kazakistan, Letonia, Lihtenshtajni, Lituania Polonia, Republika Çeke, Serbia dhe Shqipëria. Në fokusin qendror të seminarit ishin diskutimet lidhur me aspektet praktike të modelizimit për kategoritë e ndryshme të riskut në industrinë e sigurimeve.

Drejtues të departamenteve nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të Polonisë, si edhe ekspertë të tregut të sigurimeve, paraqitën eksperiencat e tyre lidhur me tregun. Po kështu profesorë dhe konsulentë privatë paraqitën prezantime për tematika të veçanta. Këto i shërbyen shkëmbimit më të mirë të eksperiencave ndërmjet autoriteteve mbikëqyrëse. Nëpërmjet rasteve studimore dhe shembujve konkretë pjesëmarrësit diskutuan gjerësisht lidhur me:

- Modelet e brendshme, vlefshmërinë e tyre, problemet, sfidat kryesore;
- Solvency II, korniza rregullative dhe kërkesat;
- Riskun e marrjes në sigurim për kompanitë e Jo-Jetës;
- *NatCat* (modelimi i riskut lidhur me katastrofat natyrore) si edhe udhëzimet e praktikave më të mira për menaxhimin e tyre;
- Çështje të zgjedhura mbi modelimin e riskut të tregut si edhe shembuj konkretë mbi modelimin e normës së interesit me fokus Solvency II.

Në seminar u përshkruan edhe eksperiencat e vendeve të tjera pjesëmarrëse mbi modelet e brendshme duke konsideruar avantazhet dhe kufizimet e tyre. Gjatë seancave të veçanta të trajnimit u theksua edhe rëndësia e një sistemi qendror të mbledhjes së të dhënave, *Data Warehouse*, për aplikimin e modeleve të brendshme.

Me raste studimore u diskutua për *NatCat* (modelimi i riskut lidhur me katastrofat natyrore) si edhe udhëzimet e praktikave më të mira për menaxhimin e tyre.

Seminar ndërkombëtar “Vendosja e konsumatorit në qendër të rregullimit dhe mbikëqyrjes”

(27-30 nëntor)

Autoriteti Financiar për Mbikëqyrjen Tregut (*Financial Conduct Authority, FCA*) i Britanisë së Madhe në bashkëpunim me Organizatën Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Letrave me Vlerë (IOSCO), organizuan më 27-30 Nëntor 2013 në Londër seminarin e përvitshëm ndërkombëtar me temë “Vendosja e konsumatorit në qendër të rregullimit dhe mbikëqyrjes”. Pjesëmarrës në këtë seminar ishin përfaqësues nga autoritete rregullatore të vendeve të ndryshme.

Temat kryesore të diskutimit për mbrojtjen e konsumatorëve dhe mbikëqyrjen e tregjeve u prezantuan nga ekspertë të nivelit të lartë të FCA-së, autoriteteve rregullatore financiare nga Holanda, Hong Kong-u, Dubai. Prezantime për tematika të veçanta pati edhe nga përfaqësues të organizmave ndërkombëtare financiare si G20 e OECD. Diskutimet u fokusuan edhe në çështjet që lidhen me ndryshimet në kuadrin rregullator dhe standardet ndërkombëtare të zbatuara në Angli dhe vendet e BE-së si dhe zbatueshmëria e tyre në mbikëqyrjen e tregjeve.

Tematikat më të detajuara gjatë seminarit ishin:

- Reflektimi i eksperiencave të mbrojtjes konsumatore në politikat e autoritetit;
- Trajtimi i procesit të pastrimit të parave dhe krimit financiar;
- Roli konkurrues në rregullimin e shërbimeve financiare;
- Rregullimi i tregut të kredisë konsumatore dhe aplikimi i sjelljeve ekonomike në rregullimin e tregjeve, etj.

Debati mbi mbrojtjen e konsumatore dhe vënien e saj edhe në qendër të mbikëqyrjes nga autoritetet rregullatore, ndër të tjera tregoi edhe se sa e rëndësishme është ndjekja e hapave dhe procedurave të tilla si ato të autorizimit të firmave individuale dhe mbikëqyrjes së tyre; veprimeve të zbatueshmerisë; konkurrencës efektive, etj.

Temat kryesore të diskutimit për mbrojtjen e konsumatorëve dhe mbikëqyrjen e tregjeve u prezantuan nga ekspertë të nivelit të lartë të FCA-së, autoriteteve rregullatore financiare nga Holanda, Hong Kong-u, Dubai.

LAJMET NGA RAJONI

GREQI

www.xprimm.com

Në tremujorin e III-të vitit 2013, tregu i sigurimeve greke arriti një vlerë prej 2.86 bilion euro ose 10.1% më pak krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Shifrat janë prezantuar nga Shoqata Greke e Kompanive të Sigurimit (HAIC). Segmenti i sigurimit



Sipas mediave lokale, “lufta e çmimeve” për primin e sigurimit të makinës në Greqi është ajo që influencon rënien e volumit në këtë sektor.

të Jetës është ulur me 16.2 % krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Po kështu segmenti i Jo-Jetës raportoi një dinamikë negative prej 5.2 % rënie, e cila i dedikohet një rënie prej 10.3 % të sigurimeve të mjeteve motorike. Sigurimi MTPL, që përfaqëson 29.3 % të totalit të tregut sigurimit të Jo-Jetës, u ul me 6.5 % krahasuar me tremujorin e III-të të vitit 2012.


Sipas mediave lokale, “lufta e çmimeve” për primin e sigurimit të makinës në Greqi është ajo që influencon rënien e volumit në këtë sektor. Në të njëjtën kohë, siç njofton e përditshmja Ekathimerini “të dhënat konfirmojnë se rënia nuk është për shkak të reduktimit të numrit të automjeteve të siguruar, por për shkak të konkurrencës së ashpër në mes të kompanive, që ka çuar në rënien e primeve. Në fakt, duket se rënia e çmimeve ka çuar në rritje të numrit të makinave të siguruar.” (*Ekathimerini.com*)

Po e njëjta gazetë raportoi se në fund të muajit tetor 2013, numri i automjeteve të siguruar ishte 5.7 milion nga 5.3 milion që ishte në dhjetor 2012. “Rënia e primeve e ka bërë sigurimin e detyrueshëm të automjeteve më tërheqës për qytetarët. Por përveç këtij fakti, edhe frika ndaj gjobave në rast të mos bërje të këtij sigurimi, të diktuar nga një ligj i kohëve të fundit, ka rezultuar edhe në rritje të numrit të makinave të siguruar. Megjithatë, ka ende rreth 1 milion makina të pasiguruar, vlerëson gazeta Ekathimerini.”

KOSOVË

www.xprimm.com

Sipas të dhënave të publikuara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK), tregu i sigurimeve ka raportuar një rezultat negativ për tremujorin e III-të vitit 2013. Primet e shkruara bruto arritën në 60.2 milion euro, ose 5% më pak krahasuar me periudhën janar-shtator 2012. Në të njëjtën kohë, dëmet e paguara nga siguruesit u rritën me 37% ose në 29.5 milion euro.



Përsa i përket numrit të kontratave, siguruesit shitën afro 730,000 polica ose 152,000 më shumë se në tremujorin e III-të vitit 2012. Kjo shtesë vjen si pasojë e rritjes së shitjeve të policave MTPL (rreth 42,000 polica më shumë) dhe policave kufitare (87,000 polica më shumë).

KROACI

www.xprimm.com

Byroja e Kroate e Sigurimeve publikoi shifrat se tregu kroat i sigurimeve arriti në vlerën 6.9 miliard HRK (rreth 910 milion euro) gjatë nëntëmujorit të vitit 2013, me një rritje prej 0.96% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.



Sigurimi i Jetës u rrit gjatë kësaj periudhe me 4.7% dhe ai zë rreth 26.2% të vëllimit të përgjithshëm të primeve. Për sa i përket

sigurimit të Jetës, pjesa më e madhe e tyre është e lidhur me policat tradicionale, rreth 87% e segmentit të sigurimit të Jetës.

Në të njëjtën kohë, primet e sigurimit të Jo-Jetës arritën në 5.1 miliardë HRK, (rreth 668 milion euro) me një rënie prej 0.3% në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë duke përfaqësuar 73.8% të tregut. Sigurimi motorik përbënin një të tretën e tregut, me vlerë 2.3 miliardë HRK (rreth 300 milionë euro) e ndjekur nga sigurimi i pronës që zë mbi 15% dhe sigurim Kasko që zë rreth 7.4%.

RUMANI

www.xprimm.com

Sipas të dhënave paraprake nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në Rumani, tregu i sigurimeve ka mbajtur një ritëm konstant deri në fund të tremujorit të tretë, me një rritje të primeve prej 0.1% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2012, duke arritur në 1.4 miliard euro. Në të njëjtën kohë, dëmet e paguara arritën në 838 milion euro, duke shënuar një ulje prej 2,44% nga viti i kaluar. Ky stanjacion është shkaktuar kryesisht nga rënia prej 4.49% në sigurimin e Jetës.



10 siguruesit e kryesore zënë më shumë se 81% të tregut, ndërsa 3 kompanitë udhëheqëse kanë sëbashku afro 34.1% të tregut.

Pjesën kryesore të shitjeve (rreth 37%) e përbën shitja e MTPL, e cila regjistroi një rritje 13.8% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Ndërkohë, sigurimi Kasko vazhdoi rënien gjatë kësaj periudhe, me 8.32% duke arritur në vlerën 298 milionë euro.

Një tendencë pozitive është regjistruar nga brokerat e sigurimit, të cilët kanë zënë pothuajse gjysmën e tregut, rreth 47.28%.

Pothuajse gjysma e shtëpive rumune janë të siguruara

Të dhënat e fundit të publikuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare i Rumanisë tregojnë se gjatë nëntë muajve të vitit 2013, shkalla e penetrimit të sigurimit për shtëpitë e banimit në Rumani arriti në 47.1% (nëpërmjet sigurimit të detyrueshëm dhe atij vullnetar).

Afro 42% e shtëpive rumune kanë sigurim vullnetar për shtëpitë, ndërsa pjesa tjetër e tyre janë të mbrojtura me anë të sigurimit të detyrueshëm. Sipas të dhënave të autoritetit, në nëntë muajt e vitit 2013 rreth 3,484,121 familje kanë në përdorin polica aktive të sigurimit vullnetar të shtëpive. Kjo shifër është 5.39% më shumë në krahasim me të njëjtën periudhë në vitin 2012.

Të dhënat e fundit të publikuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare i Rumanisë tregojnë se gjatë nëntë muajve të vitit 2013, shkalla e penetrimit të sigurimit për shtëpitë e banimit në Rumani arriti në 47.1%

Që nga 1 shtator 2013, tarifat për sigurimin e detyrueshëm rregullohen nga Banka Qendrore e Rusisë.

Në periudhën janar-shtator 2013, primi i shkruar bruto nga siguruesit lokalë arriti 474 milion RON (106.5 milion euro) në segmentin e sigurimit vullnetar të shtëpive, me një rritje prej 3.69% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2012. Në segmentin e sigurimit të detyrueshëm të shtëpive, primi i shkruar arriti vlerën 25.17 milion RON (5.65 milion euro) duke shënuar rreth 55.74% më shumë në krahasim me nëntëmujorin e vitit 2012.

Përqindja më e lartë e shtëpive të siguruara në Rumani deri më tani është raportuar në vitin 2011 me rreth 58%, kur autoriteti mbikëqyrës njoftoi një total prej 4.4 milion polica të sigurimit vullnetar dhe 500,000 polica të sigurimit të detyrueshëm.

RUSI

www.xprimm.com

Që nga 1 shtator 2013, tarifat për sigurimin e detyrueshëm (MTPL, sigurimi i detyrueshëm i objekteve të rrezikshme dhe sigurimi i detyrueshëm i përgjegjësive ndaj palëve të treta shkaktuar nga dëmet profesionale) rregullohen nga Banka Qendrore e Rusisë.



Në konferencën ndërkombëtare rreth tarifave për sigurimin e detyrueshëm, të organizuar kohët e fundit nga Bashkimi Rus i Siguruesve dhe Unioni Kombëtar për Siguruesit e Përgjegjësive, u shtrua përsëri nevoja e përllogaritjes aktuariale të tarifave. I gjithë komuniteti i siguruesve është përfshirë këto kohë në debate konstruktive mbi tarifat e sigurimit të detyrueshëm të objekteve të rrezikshme.

Një ekspert i sigurimeve i cituar nga Xprimm.com është shprehur se ata shpresojnë se Banka Qendrore do të jetë në gjendje të rregullojë normat me më pak influencë nga politika dhe populizmi, dhe se ajo do të udhëhiqet jo vetëm nga interesat afatshkurtra të policëmbajtësve (për të paguar më pak për sigurim dhe për të marrë sa më shumë për pretendimet e tyre), por edhe nga interesat e tyre afatgjata, në stabilitetin e tregut dhe të kompanive të sigurimeve.

Për këtë numër punuan:

*T.Baleta, R. Guri, D. Kalaja, P. Berberi, R. Eltari, Dh. Hazbiu,
M.Vaska, E. Beqir-Aga, E. Kokona*